




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës

Opština Mitrovica Municipality of Mitrovica

Nr. Prot. 75527 datë 06.10.2016



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Nr. Prot. 334/16 datë 06.10.2016

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Neni 1

Ky memorandum lidhet ndërmjet palëve të mëposhtme:

Komuna e Mitrovicës - Mitrovicë

Kolegji "BIZNESI" - Prishtinë

Neni 2

Qëllimi dhe Arsyetimi i memorandumit

Qëllimi i këtij memorandum është që të përcaktojë fushëveprimin e bashkëpunimit të palëve për realizmin e interesave të dyanshme në fushën e njohurive kërkimore dhe shkencore.



Neni 3

Fushëveprimi i bashkëpunimit


1. Palët pajtohen që të bashkëpunojnë për kualifikimin e kuadrove të reja dhe njëkohësisht të japin ndihmë reciproke në këtë aspekt,
2. Kolegji shpërndan periodikisht në shkollat e mesme broshurat dhe materialet me karakter edukativ, për të informuar brezin e ri mbi argumentet e ekonomisë, financës, dhe emergjencave të konceptuara në mënyrë të posaçme për ta,
3. Komuna merr përsipër që studentët e kolegjit "Biznesi" të regjionit të Mitrovicës të bëjnë punë praktike ne institucionet e veta,
4. Kolegji organizon vizita studimore, konferenca të drejtuara për nxënësit e shkollave të mesme të larta në ambientet e kolegjit,
5. Kolegji do te ju mundësoj nxënësve të shkollave të mesme të larta vijimin e kurseve për përgatitjen e testit kombëtar,
6. Palët organizojnë aktivitete të përbashkëta si takime dhe/ ose tryeza pune me pjesëmarrjen e specialisteve të të dyja Palëve,
7. Kolegji "BIZNESI" i ofron mundësi stafit të Komunës pjesëmarrje në konferenca, seminare, hulumtime dhe kërkime shkencore.

Neni 4

Ky memorandum hyn ne fuqi ditën e nënshkrimit

Për Komunën e Mitrovicës

Z. Agim Bahtiri Kryetar



Për Kolegjin "BIZNESI"

Prof.dr. Shyqeri Kabashi-Dekan

